



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:326012
Datë: 30.01.2025
Numri i dokumentit: 06782939

C.nr.5963/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesionale Valbona Abdyli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. L. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Klinaku& Associates, me adresë në Prishtinë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Ulpianë, C-2,2/6, Hyrja 101, kundër të paditurave: Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës-Spitali Rajonal në Gjilan dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me adresë në ish Pallatine Rilindjes, Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e shtesës mujore në shëndetësi, me vlerë të kontestit 869.44 euro, jashtë seancës, me datë 15.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëses F. L. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar, që të detyrohen të paditurat Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, që paditëses në emër të shtesës mujore për periudhën kohore nga data 06.02.2023 deri me datë 30.08.2024, për secilin muaj nga 45.76 euro, për 19 muaj, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 869.44 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 12.11.2024, ka paraqitur padi ndaj të paditurave, për kompensimin e shtesës mujore në shëndetësi. Në padi ka theksuar se është e punësuar në Spitalin Rajonal në Gjilan. Ka shtuar se baza juridike e kërkesëpadisë për pagesën e pagës shtesë është e bazuar në Deklaratën e Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, të datës 14.10.2008, me të cilën parashihet shtesa në pagë në vlerë prej 45.76 euro për vitet në vijim. Tutje, ka pretenduar se me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese është shpallur i pavlefshëm paragrafi 2, 3 dhe 4 i nenit 41 dhe paragrafi 2 i nenit 45 i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, andaj duke qenë se me këtë Aktgjykim është shpallur i pavlefshëm neni 45 par. 2 i Ligjit, atëherë paditëses duhet t'i paguhet kompensimi sipas Deklaratës së lartcekur. Nga Gjykata ka kërkuar që ta detyrojë të paditurën që paditëses në emër të pagës shtesë për periudhën kohore nga data 06.02.2023 deri me datë 30.08.2024, për

19 muaj nga 45,76 euro për secilin muaj, t'ia paguajë shumën prej 869.40 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar sipas tarifës së TOAK-së.

E paditura e parë në përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Ka theksuar se se sa i përket ekzekutimit të shtesave në pagë, Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin dhe implementimin e Ligjit nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili ka hyrë në fuqi më datë 04.01.2023. Në kapitullin e II të Ligjit nr.08/L-196, janë paraparë kompensimet të cilat mund të përfitohen në bazë të këtij ligji siç janë (kompensimi për kujdestari, punën gjatë natës, kompensimi për udhëtime, etj), mirëpo, në asnjë nen nuk ceket se bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publik të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës është paraparë kompensimi prej 44.00 euro. Po ashtu e kanë kundërshtuar edhe provën e ofruar – Deklaratën e Përbashkët nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federates Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, pasi që nga kjo provë nuk vërtetohet se për çfarë arsye është dhënë ky kompensim, pasi që nuk përcaktohet fare lloji i kompensimit, por vetëm citohet kompensimi në lartësi prej 44.00 euro. Bazuar në këto pretendime, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses, ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

E paditura e dytë, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigje e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pa lejuar, po ashtu e ka kontestuar edhe legjitimitetin real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkëngjitura, erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritore duke refuzuar kërkesëpadisë së paditëses pa caktuar fare seancë gjyqësore, bazuar në nenin 399 par.1 dhe 2 të LPK-së, ku përcaktohet “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”

Nga provat e bashkëngjitura në padi, rezulton se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie të punës me të paditurën në bazë të kontratës së punës me nr.2368 të datës 31.12.2012, sipas të cilës është e sistemuar në pozitën e punës servuese.

Gjykata gjen se kërkesa e paditëses mbështetet në Deklaratën e Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës të datës 14.10.2008. Nga vlerësimi i kësaj deklarate, konstatohet se kjo deklaratë nuk ka fuqinë e aktit ligjor apo nënligjor dhe nuk paraqet dokument detyrues për të paditurën. Kjo nënkupton se, pavarësisht marrëveshjes mes palëve të përfshira, Deklarata nuk ka kaluar procesin e nevojshëm të miratimit ligjor dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret si një dokument ligjërish detyrues. Gjykata, duke vlerësuar bazën juridike të kërkesëpadisë, konstaton se çdo pretendim për kompensim duhet të mbështetet në një bazë të vlefshme juridike dhe e paditura nuk mund të detyrohet të përmbushë një kërkesë mbi bazën e një deklarate që nuk ka fuqinë e një akti ligjor apo nënligjor të miratuar sipas procedurës përkatëse. Për më tepër, Ligji për Pagat në Sektorin Publik në nenin 30 [Shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor] dhe në nenin 33 [Shtesa funksionale për nëpunësen/in e sistemit

shëndetësor] ka përcaktuar shtesat për nëpunësit e sistemit shëndetësor dhe njëkohësisht ka përcaktuar edhe kushtet për përfitimin e këtyre shtesave, e që për pasojë, shtesa e pretenduar për kompensimin kontestues, nuk hyn në kategorinë e këtyre shtesave.

Gjykata, ka vlerësuar pretendimin e paditëses se me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese është shpallur i pavlefshëm paragrafi 2, 3 dhe 4 i nenit 41 (shtesa tranzitore) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi) i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe mbi këtë bazë paditëses i takon e drejta në kompensim në lartësi prej 45.76 euro në muaj. Megjithatë, duke qenë se kërkesa e paditëses nuk mbështetet në një akt ligjor apo nënligjor por në një deklaratë e cila, për arsyet që u elaboruan më lartë, u konstatua se nuk prodhon efekte juridike, një pretendim të tillë e vlerësohet i pabazuar.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenet 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit në procedurë, e paditura nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.5963/24, më datë 15.01.2025

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.